



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT
O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Më datë 27.07.2017, Mekanizmi Parandalues Nacional MPN realizoi vizitë të paparalajmëruar në Stacionin policor Shën Nikollë (SP Shën Nikollë). Vizita filloi në ora 10:00 dhe përfundoi në ora 14:00 (kohëzgjatja e përgjithshme 4 orë). Paraprakisht, Stacioni policor Shën Nikollë u vizitua nga Ekipi i MPN-së më datë 28.02.2012.

Vizitën në SP Shën Nikollë, Ekipi i MPN e realizoi në kuadër të mandatit të Avokatit të Popullit - Mekanizmit Parandalues Nacional, i cili buron nga Protokollin Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese dhe Ndëshkuese dhe Ligji i Avokatit të Popullit. Me Protokollin Fakultativ përkufizohet se MPN-ja realizon vizita të rregullta në vendet ku personat mund të privohen nga liria, me qëllim të identifikimit të rreziqeve për shkak të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Stacioni policor gjendet në një ndërtesë të vjetër me ndërtim të fortë, e cila ka hapësira në bodrum, në pjesën përdhese dhe një kat. Në momentin e vizitës nuk kishte persona të ndaluar, me të cilët ekipi i MPN-së do të mund të bisedonte lidhur me trajtimin e tyre nga ana e nëpunësve policorë, realizimin e të drejtave të tyre, si dhe për kushtet e ndalimit në këtë stacion policor.

Në përputhje me Aktvendimin për përcaktimin e stacioneve policore për ndalimin e personave, ky Stacion policor është caktuar si stacion policor në të cilin mund të zbatohet ndalimi, megjithatë, i njëjti nuk i përmbush standardet e parapara minimale vendase dhe ndërkombëtare për ndalimin e personave të privuar nga liria.

SP Shën Nikollë disponon me tri hapësira për ndalimin e personave dhe të njëjtat gjenden në pjesën e bodrumit të Stacionit policor. Të gjitha hapësirat janë dedikuar për ndalime individuale (me nga një krevat në hapësirë) dhe në to nuk ka të instaluar video-mbikëqyrje, ndërsa komunikimi i personave të ndaluar me përgjegjës të nëpunësve policor (përgjegjës i turnit) bëhet përmes sistemit funksional për thirrje.

Në lidhje me ngrohjen e hapësirave, MPN-ja konstatoi se nuk ka kurrfarë trupa ngrohës, me çka seriozisht vihet në pikëpyetje ngrohja gjatë periudhës së dimrit, ndërkohë që u vërejt lagështi shumë e madhe në mure (janë matur mbi 60% R.H. vlera).

Si mbrojtje dhe masa plotësuese të sigurisë, në SP Shën Nikollë, zbatohet mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e personave të ndaluar, me çka regjistrohet dhe evidentohet në fletë të veçantë kontrolluese, me qëllim që në kohë dhe në mënyrë parandaluese të veprohet kur një gjë të këtuillë e kërkon veprimi urgjent.

Gjatë këqyrjes së hapësirave të ndalimit, Ekipi i MPN-së konstatoi se ishin të rregullta dhe të pastra, të pajisura në mënyrë adekuate me mjete për pushim (për ndalime të shkurtra dhe ndalime gjatë natës), siç është dysheku, batanija dhe jastëku.

Hapësirat nuk i përmbushin standardet të cilat kanë të bëjnë me ndriçimin natyral dhe ndriçimin plotësues, për shkak se në to qarkullimi ndriçimit ditor është tejet i dobët, për shkak të dritareve metalike me dimension së vogël të hapjes, por edhe për shkak se nuk ka ndriçim artificial (plotësues), por i njëjti hyn përmes korridorit dhe hapjes mbi derë.

Në përbërje të objektit dhe hapësirave për ndalimin e personave të privuar nga liria ka nyje të veçantë sanitare për personat e ndaluar, e cila është e vjetër dhe e pa rinovuar dhe në të njëjtën, Ekipi i MPN-së nuk vërejti kurrfarë mjjetesh për mirëmbajtjen e higjienës. Shqetëson fakti se nyja sanitare është e hapur (nuk është e mbrojtur me derë, perde...) dhe personat e ndaluar u nënshtrohen vështrimeve nga ana e nëpunësve të uniformuar policorë, me çka cenohet e drejta e privatësisë dhe intimitetit të personave të ndaluar. Në këtë drejtim, MPN-ja sugjeroi se nevojitet që nyja sanitare të ndahet fizikisht nga pjesa tjetër e hapësirës (me vendosjen e derës së veçantë apo me mbulimin me material prej plastike).

Me qëllim të marrjes së informacioneve për aktivitetet e ndërmarra dhe për trajtimin e nëpunësve policorë me personat e arrestuar, personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi këqyrje edhe në evidencat dhe dosjet individuale të cilat udhëhiqen në këtë Stacion policor.

Nga këqyrja në **Regjistrin e personave të privuar nga liria**, mund të konstatohet se i njëjti udhëhiqet në rregull, në mënyrë të qartë dhe të lexueshme. Regjistri është objekt i kontrollit të rregullt edhe nga nëpunësit zyrtarë, të cilët i kontrollojnë të dhënat dhe e konfirmojnë saktësinë e tyre dhe kohën, me nënshkrimin e tyre personal. Ekipi i MPN-së, nga këqyrja mbi këtë libër konstatoi lëshime sa i përket shënimit të orës se kur janë privuar personat nga liria, e që çon deri te qëllimi eventual për fshehjen e kohës së saktë në të cilën personi është privuar nga liria. Në këtë drejtim, Mekanizmi Parandalues Nacional sugjeroi të kihet kujdes më të madh gjatë evidentimit të të dhënave në rubrikat përkatëse, në çdonjërin nga librat për evidencë.

Përshtypje e përgjithshme nga këqyrja në regjistrat e përmendur është se evidenca udhëhiqet në mënyrë të lexueshme, të qartë dhe në rregull. Në librat për evidencë, të cilët udhëhiqen për tre vitet e fundin, nuk përdoret fare llaku korrektues dhe vërehet rrjedha kronologjike e ngjarjeve të evidentuara. Gjithashtu, nga këqyrja

e realizuar në disa dosje individuale, të evidentuara në Stacionin policor, mbi cilëndo qoftë bazë, Ekipi i MPN-së konstatoi se dokumentacioni udhëhiqet në rregull dhe se përpilohen në kohë dokumentet për çdo ngjarje, gjatë kohëzgjatjes së shkaqeve të qëndrimit të personit në Stacionin policor.

Si rezultat i vizitës së realizuar, Mekanizmi Parandalues Nacional përpiloi raport në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime të cilat ia dërgoi Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Stacionit policor, me qëllim që të eliminohen mangësitë dhe rreziqet.